



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 961/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Numan Baliq dhe Fahrudin Mexhedoviq paraqitur kundër Jasmîn Agoviq në njëerën anë dhe ankesa e paraqitur nga Rrustem Nurkoviç paraqitur ndaj Numan Baliqit në anën tjetër, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN si të palejuara ankesat e Rrustem Nurkoviçit, Numan Baliqit dhe Fahrudin Mexhedoviqit.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 26.11.2013, ka pranuar aktin përcjellës me shkresat e lëndës PP/I.nr. 348/13 të datës 19.11.2013 nga Prokuroria Themelore në Pejë e cila dërgon në kompetencë çështjen kundër subjekteve politike Vakati dega në Vitomiricë, KK Pejë dhe subjektit politik SDA me seli në Vitomiricë, KK Pejë për shqyrtim dhe vendosje dhe së bashku me aktin përcjellës ia ka bashkangjitur të gjitha provat e mbledhura nga ana e kësaj prokurorie gjatë hetimeve të zhvilluara në këtë çështje.

Me datën 11.11.2013 Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Pejë ka paraqitur kallëzim penal kundër të dyshuarit Jasmin Agoviq nga Vitomirica e Pejës nën dyshimin se ka kryer veprën penale “cenim i së drejtës për të kandiduar” neni 210 i KPRK-së me dyshimin se i lartcekuri në bashkëpunim me Husnija Beshkoviçit, Rrustem Nurkoviçit dhe Qeman Mehmeti kanë keqpërdorur disa fotografi montazh të montuara ku shihen Numan Baliqi, Sllobodan Millosheviqi dhe Fahrudin Mexhedoviqi duke i vendosur në vendet publike në Vitomiricë dhe duke i publikuar rrjetin social Facebook. Për rastin në fjalë Prokurori i rastit me datën 31.10.2013 ka autorizuar policin e Kosovës që të fillojë hetimet, ku me ç’rast gjatë hetimit të kryer është kuptuar se publikimin e fotove të montuara në rrjetin social e ka bërë i dyshuari i lartcekur Jasmin Agoviq dhe i cili me datën 31.10.2013 është arrestuar dhe është dërguar para prokurorit të shtetit dhe se pas intervistimit të dyshuarit nga ana e

prokurorit, i është caktuar masa e ndalimit policor prej 24 orëve. Me datën 01.11.2013 në polici kanë shkuar personat Rustem Nurković dhe Husnija Beshković nga Vakat ku kanë paraqitur ankesë ndaj personave të partisë SDA për shpifje dhe kërcënim ku për këtë rast është njoftuar prokuroria dhe rasti është proceduar si i rregullt.

Në shkresën me nr PP.I.348/13 të datës 31.1.2013 Prokuroria Themelore kishte hapur dhe kishte filluar procedurën penale kundër Husnija Beshkovićit nga fshati Bllagaj komuna e Pejës për veprë penale cenim i të drejtës për tu kandiduar nga neni 210 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa në shkresën me nr PP.I.348/13 të datës 12.11.2013 kishte filluar procedurën penale kundër Numan Baliqit përshkak të fyerjeve dhe kërcënimeve të bëra përmes radios Hajat dhe përmes facebookut ndaj Rustem Nurkovićit veprime këto të sanksionuara me nenin 210 paragrafi 2 të KPRK-së cenim i të drejtës për të kandiduar.

Me datën 20.11.2013 shkresa me nr PP/I.nr. 348/13 Prokuroria Themelore në Pejë , Departamenti i Krimeve të Rënda ka marrë vendim për pushimin e hetimeve për Husnija Beshkovićin, Rustem Nurkovićin, Qeman Mehmeti, Jasmin Agovićin dhe Numan Baliqin ngase pas hetimeve zyrtare të zhvilluara në këtë çështje prokuroria ka konsideruar se në veprimet e të pandehurve nuk ekzistojnë elemente të veprës penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Për të dyshuarin Jasmin Agović gjatë hetimeve të bëra dhe nga deklarata e dhënë në prokurori nuk është vërtetuar dhe nuk është gjetur se i përket ndonjë subjekti politik të apostrofuar në ankesë, ndërsa për të dëmtuarit Numan Baliq dhe Fahrudin Mexhedović gjatë hetimeve dhe deklaratave të dhënë në prokurori e pranojnë se asnjëri nga ata nuk ka qenë kandidat i këtij subjekti politik pra i SDA-së për këto zgjedhjeve.

Sa i përket personave Husnija, Rustem dhe Qeman prokuroria nuk ka mundur të vërtetoj me asnjë provë se të lartpërmendurit ta kenë urdhëruar apo në çfarëdo mënyre ta kenë kryer në bashkëveprim me Jasmin Agovićin veprën penale për të cilën janë dyshuar. Ndërsa për Numan Baliqin i cili dyshohej për veprën penale kanosje ndaj Rustem Nurkovićit, prokuroria me asnjë provë materiale apo personale nuk ka mundur të vërtetoj se i njëjti ka parandaluar apo ka dëmtuar Rustem Nurkovićin për tu kandiduar në zgjedhje.

PZAP-i, konstatoi se ankesa **është e palejuar** ngase me nenin 115.1 të LZP-së, parashihet se: *“PZAPi është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore”*. Ndërsa neni 33 i LZP-së përcakton veprimet e ndaluara **gjatë fushatës zgjedhore të subjekteve politike, të mbështetësve të tyre ose kandidatëve të saj nga bërja e veprimeve si në pikat a), b), c), d), e), g), h), j), k), l), m), i), ii)** të LZP-së. Andaj PZAP- duke u nisur nga dispozita e lartcekura ligjore ka gjetur se nuk është nën juridiksionin e saj rasti në fjalë pasi që personi Jasmin Agović nga deklaratat e dhëna në Prokurori për asnjë moment nuk është arritur që të vërtetohet se i lartcekuri i përket ndonjë subjekti politik, ndërsa për personat e tjerë si Rustem Nurković, Husnija Beshković, Qema Mehmeti dhe Numan Baliq prokuroria nuk ka gjetur ndonjë element që do të bënte përgjegjëse për veprimet e tyre dhe se personat e lartcekur në deklaratat e dhëna në prokurori kanë deklaruar se nuk kanë qenë pjesëmarrës apo si kandidat për zgjedhjet lokale, andaj PZAP-i mbi këtë bazë ka konstatuar se nuk është në juridiksionin e saj që të ndërmarr masa ligjore ndaj personave në fjalë ngase dispozitave të lartcekura ligjore i detyrohen vetëm personat ose kandidatët që marrin pjesë dhe që kanë të bëjnë me procesin

zgjedhor, andaj duke u bazuar nenin 115.1 dhe 118.1 të LZP-së dhe nenin 4.2 të Rregullave dhe procedurave të PZAP-it u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 961/2013 më datën 10.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.